



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:139556
Datë: 19.03.2024
C.nr.1309/2021 Numri i dokumentit: 05474453

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.G. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.K. nga Prizreni, kundër të paditurit R.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. R.K. nga Prizreni, me objekt të kontestit dorëzimi i paluajtshmërisë, vlera e kontestit 3,100.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore, sipas padisë së paditësit M.G. nga Prizreni, me numër C.nr.1309/2021 e datës 30.06.2021, kundër të paditurit R.B. nga Prizreni, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.

II. Procedura e ndërprerë sa i përket pikës nën I. të dispozitivit, do të vazhdohet pasi të përfundojë procedura në formë të prerë tek organi kompetent, apo kur gjykata e çështjes konstaton se nuk ekzistojnë më arsyet për të pritur përfundimin e saj.

A r s y e t i m

Paditësi M.G. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurit R.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. R.K. nga Prizreni, me objekt të kontestit dorëzimi i paluajtshmërisë, vlera e kontestit 3,100.00 euro.

Në seancën përgatitore të datës 26.02.2024, i autorizuari i të paditurit gjykatën e ka njoftuar se i padituri, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për vërtetimin e pronësisë nën numrin C.nr.755/19, ku i padituri është në cilësi të paditësit, ndërsa paditësi në cilësi të të paditurit. Andaj, gjykatës i ka propozuar që procedura në çështjen juridike C.nr.1309/2021 të ndërpritet, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake lidhur me çështjen juridike C.nr.755/19, ndërsa nuk jep pëlqimin dhe nuk pajtohet që të bëhet bashkimi i këtyre dy lëndëve, lëndës C.nr.755/2019 dhe C.nr.1309/2021.

I autorizuari i paditësit përmes parashtrësës së datës 29.02.2024, ka propozuar që të shikohet mundësia që të bëhet bashkimi i dy çështjeve juridike C.nr.755/2019 dhe C.nr.1309/2021, në përputhje me nenin 408 par. 1 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) dhe të kihet parasysh edhe paragrafi 2 i nenit 408 të LPK-së.

Nga arsyet dhe faktet e theksuara më lartë, gjykata gjeti se procedura gjyqësore lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë në ngastrën kadastrale kontestuese, përbënë çështje paraprake në këtë çështje juridike, e cila duhet të zgjidhet në procedurë gjyqësore të veçantë dhe të ndarë nga kjo procedurë kontestimore.

Kësisoj, në nenin 13 të LPK-së theksohet që “kur vendimi i gjykatës varet nga zgjidhja paraprake e çështjes se a ekziston ndonjë e drejtë subjektive apo marrëdhënie juridike, e lidhur me të ende nuk ka marrë vendim, gjykata apo organi tjetër kompetent (çështja paraprake), atëherë gjykata ka tagër që vetë ta zgjidhë çështjen e tillë, në qoftë se me dispozita të veçanta nuk është caktuar ndryshe”. Pastaj, me nenin 278 par. 1 pika a) parashihet se “përveç rasteve të parashikuara me këtë ligj, gjykata e ndërpret gjykimin po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidhë çështjen paraprake (neni 13 i këtij ligji)”.

Po ashtu, gjykata ka pas parasysh mundësinë e bashkimit të dy çështjeve juridike C.nr.755/2019 dhe C.nr.1309/2021, mirëpo nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 408 të LPK-së. Më konkretisht, me nenin 408 par. 1 të LPK-së parashihet që “po që se në të njëjtën gjykatë janë në zhvillim e sipër dy apo më tepër gjykime ndërmjet personave të njëjtë, apo në të cilat i njëjti person është kundërshtar i paditësve apo të paditurve të ndryshëm, gjykata mund t’i bashkojë të gjitha ato me aktvendim me qëllim të shqyrtimit të përbashkët, nëse me një gjë të tillë do të zvogëloheshin shpenzimet dhe do të përshpejtohej shqyrtimi i çështjeve. Për të gjitha gjykimet e bashkuara jepet një aktgjykim i përbashkët”. Ndërsa, në paragrafin 3 të nenit 408 të LPK-së përcaktohet se “për të vepruar sipas paragrafit 1 të këtij neni nevojitet pëlqimi i palëve”. Në këtë drejtim, gjykata erdhi në përfundim se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 408 par. 3 të LPK-së, pasi që pala e paditur nuk ka dhënë pëlqimin për bashkimin e lëndëve përkatëse.

Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar pretendimin e palës paditëse dhënë në parashtresën e datës 29.02.2024 që gjykata të ketë parasysh nenin 408 par. 2 të LPK-së, mirëpo gjeti se në dispozitë e tillë ligjore nuk gjen zbatim lidhur me këtë çështje. Kështu, në nenin 408 par. 3 të LPK-së theksohet që “gjykata mund të vendos që të shqyrtohet në mënyrë të veçantë ndonjë kërkesë e një padie unike, dhe pas shqyrtimit të tillë, të jep vendime të posaçme mbi kërkesat e padisë”. Pra, në këtë dispozitë ligjore parashihet mundësia e veçimit të kërkesave, përkatësisht të procedurës, nëse në padinë e palës paditëse ekzistojnë disa kërkesa. Në rastin konkret, me padinë C.nr.1309/2021 e datës 30.06.2021, ekzistonte vetëm një kërkesë, ajo për dorëzimin e paluajtshmërisë lidhur me ngastrën kadastrale kontestuese. Në këtë drejtim, ky pretendim dhe propozim është i pabazuar dhe pa justifikim të qartë juridik.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, konform nenit 13, 278 dhe 280 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1309/2021, datë 19.03.2024

Gj y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.